

Fjala e plotë e Presidentit të Republikës, Z.Bujar Nishani

Të nderuar pjesëmarrës,

I nderuar Kryetar i Kuvendit, Kryeministër, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarë,

Të nderuar të ftuar,

Është një kënaqësi e veçantë të jem i pranishëm në këtë konferencë shkencore, kushtuar gurit të themelit të një shteti, Kushtetutës, në këtë 15-vjetor të saj.

Edhe pse i ri në moshë, ky akt themeltar paraqet një rëndësi të veçantë për të gjithë sistemin shtetëror e shoqëror.

Supremacia e këtij akti themeltar është e padyshimtë, dhe pikërisht prej këtu lindin edhe institucionet në themel të shtetit tonë, bashkërisht me misionin dhe rolin e tyre në garantimin e rendit kushtetues dhe të lirive e të drejtave të shtetasve.

Superioriteti i Kushtetutës në hierarkinë e piramidës së burimeve të së drejtës, është shumë i rëndësishëm për krijimin dhe ruajtjen e strukturës shtetërore.

Besoj se kjo epërsi e mban Kushtetutën jashtë zhvillimeve të politikës së zakonshme, por jo larg vëmendjes se saj, duke bërë që strukturat themelore të shtetit të qëndrojnë mbi politikën elektorale dhe të sigurojnë paprekshmërinë e sistemit shtetëror pavarësisht nga rezultatet e zgjedhjeve si dhe çka është më e rëndësishme, pavarësisht nga forcat politike që do të fitojnë zgjedhjet.

Gjej rastin këtu, t'ju risiguroj se si President i Republikës dhe garant i Kushtetutës do të vazhdoj të jap maksimumin dhe të përdor çdo instrument kushtetues dhe ligjor me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së shtetit të së drejtës, duke respektuar dhe garantuar të drejtat e cilitdo shtetas dhe çdo elementi përbërës të shoqërisë sonë në formën e saj SHTET.

Nuk kam se si t'i shikoj apo konceptoj të shkëputura nga njeri-tjetri, respektimin e të drejtave themelore të shtetasve dhe respektimin e pavarësisë institucionale.

Çdo institucion kushtetues nuk duhet vetëm të kërkojë, por edhe të përkushtohet në garantimin maksimal si të të drejtave të shtetasve, ashtu edhe të mirëfunksionimit e tij dhe cilitdo prej institucioneve.

Në bindjen time dhe aktivitetin tim, Kushtetuta duhet të japë garanci për një jetë të gjatë dhe qëndrueshmëri.

Rishikimi duhet të jetë i rrethuar nga matura e kujdesi për të nënvizuar aspektin themelor të paktit kushtetues.

Përveçse anës historike dhe përpjekjeve të bëra nga Komisioni për hartimin e Kushtetutës për të arritur në krijimin e një Kushtetute të mirëfilltë evropiane, ajo që duhet vlerësuar është rëndësia që ky Komision i dha krijimit të një teksti kushtetues me vlerë, të qëndrueshëm dhe të aftë që t'i përgjigjej kërkesave për një sistem të drejtë evropian me themele të patundura, por që në të njëjtën kohë t'i përgjigjej edhe realitetit ekonomiko-shoqëroro-politik të vendit.

Kushtetuta e vitit 1998 është një nga elementet institucionale më të rëndësishme që qëndrojnë në bazën e demokratizimit të shtetit shqiptar.

Kushtetutat e zgjedhura në vendet postkomuniste kanë pasur një rol të rëndësishëm në demokratizimin e vendit duke arritur kështu të përcaktojnë “rolet e lojës” dhe duke influencuar direkt në mbarëvajtjen institucionale të një shteti demokratik.

Gjithsesi, mendoj se ishte e vështirë të arrihej ky qëllim, por Komisioni për Hartimin e Kushtetutës arriti t'i përgjigjet pyetjes se “Si do të bëhej e mundur të bashkëjetojnë të gjitha domosdoshmëritë në mënyrë që të limitohen konfliktet individuale apo ato kolektive, pa krijuar institucione monstruozë të cilat mund të shkelin liritë themelore?”

Unë besoj se po punojmë që edhe në vendin tonë, Kushtetuta të mos jetë vetëm akti themelor i një shteti, si akt material, por të jetë komponenti esencial i demokratizimit dhe vendosjes së shtetit të së drejtës, duke qenë mbi të gjitha shpirti i shoqërisë shqiptare, se sa thjesht mekanizmi i zakonshëm institucional.

Kushtetuta mbi të gjitha ka sensin e një pakti social, të një kontrate mes atyre që qeverisin dhe të qeverisurve, mes të cilëve vendosen parimet dhe instrumentet e një regjimi politik.

Në thelb, Kushtetuta paraqet mënyrën në të cilën populli përcakton dhe instrumentalizon fuqinë, pra rikonfirmon sovranitetin.

Teksti më i vjetër kushtetues, *stricto sensu*, ishte Magna Carta, e cila shërben akoma si një Kushtetutë e pashkruar për Britaninë e Madhe, por që në thelb solli një zhvillim të paprecedent, duke kufizuar pushtetin absolut të mbretit si dhe duke mos i lejuar të plotfuqishmit mbret të dënonte, internonte apo vriste askënd pa kaluar me parë në një proces të rregullt gjyqësor dhe ligjor.

E para Kushtetutë e shkruar në botë ishte ajo e Korsikës në 1735, ku për herë të parë në botë parashikonte parimet e sovranitetit popullor dhe parimin e ndarjes së pushteteve.

Gjithsesi, vlen të përmendet që njëherësh me zhvillimin e njerëzimit u zhvilluan edhe nocionet rreth kushtetutës si element themeltar i një shteti.

Kështu, lindja e Gjykatës Kushtetuese si institucion në botë por edhe në Shqipëri në këtë 20-vjetor të saj, i rijep një dimension real kufizimit të sovranitetit real që e gëzonin Parlamentet në përgjithësi, por edhe Kuvendi shqiptar në veçanti.

Është për t'u vlerësuar progresi që solli Kushtetuta e vitit 1998, e cila duke çrrënjosur parimet aspak demokratike si: centralizimi i pushtetit, mosrespektimi i parimit të ndarjes së pushteteve, mungesa e pluralizmit politik dhe instalimi i diktaturës së proletariatit, i ridha një frymë të re evropiane gjithë sistemit të së drejtës.

Mbi të gjitha, Kushtetuta e 1998 është një kushtetutë reale, e cila i përkon realitetit shqiptar, sidomos në parashikimet kushtuar balancimit të pushteteve apo respektimit real të të drejtave të njeriut.

Të nderuar pjesëmarrës,

Vlerësoj temën që keni zgjedhur për këtë konferencë shkencore duke dashur të nënvizoni rolin statik dhe sigurimin e qëndrueshmërisë që duhet të japë kushtetuta e një vendi, e sidomos ajo shqiptare, por mendoj se në kuadrin e aderimit në BE do të duhet të përgatitemi për modifikime të reja kushtetuese të cilat vijjnë në përputhje me shpirtin e kthimit në anëtar me të drejta të plota të Shqipërisë në familjen Evropiane.

Pikat të cilat mund të parashtroreshin për rishikim në Kushtetutën e Shqipërisë, si ka ndodhur tashmë me të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian do të konsistojnë në:

- një kufizim i sovranitetit kombëtar me anë të njohjes së institucioneve të Bashkimit Evropian për të adoptuar akte normative për shtetet anëtare. Pra, Parlamenti shqiptar nuk do të jetë i vetmi institucion ligjvënës.

- parashikimi që duhet bërë në Kushtetutë për të drejtën për pjesëmarrje të shtetasve të Bashkimit Evropian në zgjedhjet lokale të Shqipërisë si dhe e drejta e pronësisë mbi terrin apo pasuri të paluajtshme për shtetasit e huaj.

- parashikimi i të drejtës së shtetasve shqiptarë për të marrë pjesë si zgjedhës apo të zgjedhur në zgjedhjet e Parlamentit Evropian.

Rishikimi kushtetues, për të cilin sapo fola, nuk duhet kuptuar si një prekje e rëndësishme së këtij akti themel, si një kthim i Kushtetutës në një ligj të zakonshëm i cili mund të modifikohet lehtësisht, por mbetem i mendimit se çdo kushtetutë bazohet apo mbështetet në një vendim apo kompromis themelor, prandaj ajo nuk mund të vihet në pikëpyetje përmes procedurave që synojnë ndryshimin e saj.

Pasi një kushtetutë, nëse do të ishte krejtësisht e ngurtë, nuk do arrinte të jepte asnjë garanci për një jetë të gjatë dhe qëndrueshmëri, por nga ana tjetër edhe një kushtetutë e butë nuk duhet të lihet të modifikohet sipas dëshirës së shumicës politike.

Rishikimi duhet të jetë i rrethuar nga matura e kujdesi për të nënvizuar aspektin themelor të paktit kushtetues.

Pra, rishikimi i Kushtetutës duhet parë si një përsosje e saj, kur është një domosdoshmëri shoqërore, por pa prekur bërthamën e parimeve, vlerave kushtetuese që do t'i konsideronim superkushtetutë.

Në përfundim të fjalës sime, gjej rastin të përgëzoj Gjykatën Kushtetuese për punën e palodhur si “roje e Kushtetutës shqiptare”, e cila ka arritur të jetë jo vetëm tepër aktive me vendimet e saj interpretuese, në dhe për garantim të kushtetutës, por ka arritur të jetë edhe më pranë qytetarëve të cilët gjithnjë e më shumë po apelojnë tek ky institucion.

Ju faleminderit dhe suksese të mëtejshme!